



Italia dhe Spanja shprehen kundër përpjekjeve për krijimin e një patente Europiane Mungesa e grave në postet kryesore do të shkaktojë probleme për ekonominë e BE-së Europa humb një prej personaliteteve më të guximshme dhe largpamëse

# EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr.3, Qershor - Korrik 2011

## Në fokus

### Kriza e eurozonës

Debatet mbi krizën financiare kanë mbërthyer Europën dhe rivënë në diskutim projektin european. EuroSpeak pasqyron pikëpamjet e ndryshme të dy prej revistave më prestigjioze europiane, The Economist dhe Der Spiegel

**Si monedha e përbashkët u kthye në kërcënimin më të madh për Europën?**

Euro-ja është duke u bërë një kërcënim gjithnjë e më të madh për të ardhmen e përbashkët të Europës. Bashkimi Monetar lidh së bashku ekonomi që janë thjesht të papajtueshme me njëra-tjetrën. Politikanët miratojnë një paketë shpëtimi njëra pas tjetrës dhe, duke vepruar kështu, kanë hyrë në një shteg të rrezikshëm që mund t'iu ngarkojë barra brezave të europianëve që pasojnë dhe ta kthejë BE-në dekada mbrapa.

Në 14 muajt e fundit, politikanët në eurozonë kanë miratuar një paketë shpëtimi pas tjetrës, të mbledhur në samite me debate, grindje dhe kompromise dembele, duke ndërtuar rreziqe të përmasave gjigante.

...vijon në faqen 2 >>

### Qipro, bregdeti më i pastër në Bashkimin European



Foto: Panoramio

Sipas një raporti të BE-së, cilësia e ujërave në bregdetet, lumenjtë dhe liqenet e vendeve të Bashkimit European po bie gradualisht. Plazhet në Rumani, Poloni dhe Belgjikë konsiderohen më të këqijat, ndërsa ato të Qipros, Kroacisë, Maltës dhe Greqisë mbeten më të mirat. Raporti vjetor mbi cilësinë e plazheve, botuar më 16 qershor nga Agjencia Europiane e Mjedisit tregon një trend negativ në krahasim me vitin 2009.

...vijon në faqen 3 >>

### Pesë arsye për të cilat projekti european po shkërmoqet



Foto: DFS Studio

José Ignacio Torreblanca, analist i European Council on Foreign Relations, analizon në El Pais fazën në të cilën po kalon integrimi european dhe prirjen e disa vendeve anëtare për të rinacionalizuar politikat e përbashkëta, duke shënuar kështu hapa mbrapa për sa i përket integrimin.

Sipas tij "Projekti european po vihet në diskutim dhe të metat e tij po ekspozohen si rrallë ndonjëherë. Duket sikur në Europën e sotme, të pasurit e një partie të madhe politike ksenofobe është një detyrim. E vërteta është se Europa po përçahet për sa i përket katër linjave: vlerat e saj, euroja, politika e jashtme dhe lidhshipi. Nëse nuk do të ketë një ndryshim rrenjësor, procesi i

...vijon në faqen 4 >>

## Kriza e eurozonës:

...vijon nga faqja 1 >>



Foto: DFS Studio

Në tërë këtë kohë, ata i janë shmangur një konkluzioni të rëndësishëm, pikërisht se gjërat nuk mund të vazhdojnë në këtë mënyrë. Euroja e vjetër nuk ekziston më në formën për të cilën ishte parashikuar dhe Bashkimi Monetar European nuk po funksionon. Ne kemi nevojë për një plan B. Në vend që ta pranojnë këtë, personat në pozicione përgjegjësie po bëjnë të pamundurën të menaxhojnë krizën, ndërkohë që përpiqen të qetësojnë publikun dhe t'i zbukurojnë problemet.

Por, po të mos ishte për shkak të ekzistencës së euros, kriza e borxhit të Greqisë do të ishte një problem i izoluar - i vështirë për vendin, por i lehtë për tu përballuar nga Europa. Borxhet e Athinës janë një problem për të gjithë partnerët e saj vetëm sepse Greqia është pjesë e eurozonës dhe përbëjnë kështu një kërcënim për monedhën e përbashkët.

Nëse pjesa tjetër e Europës braktis Greqinë, kriza mund të dalë jashtë kontrollit, duke u përhapur nga një vend i dobët i eurozonës në tjetrin. Themeluesit e euros nuk e parashikuan një krizë të tillë, prandaj edhe nuk kanë parashikuar mekanizma në dispozicion të Bashkimit Monetar European për zgjidhjen e saj. Euroja lidh së bashku vende me ekonomi të forta dhe të dobëta, për mirë apo për keq. Nuk ka asnjë dalje emergjence, dhe nuk ka rregulla për tu ndjekur në rast emergjence - vetëm shpresa se gjithçka do të rregullohet në fund. Kjo është arsyeja pse krizat e disa vendeve të euros janë një krizë për euron, si dhe një krizë për Bashkimin European, qeveritë dhe institucionet e tij. Dhe kjo është arsyeja pse kriza e euros papritur është kthyer në një krizë për projektin politik të Europës, të ardhmen dhe kohezionin e tij.

Fakti që planeve të shpëtimit të vendeve u mungon legjitimiteti demokratik po kthehet në pengesën më të madhe për menaxhimin e përbashkët të krizës. Tani që situata është serioze, vendimet po bëhen në mënyrë demokratike nga organet disi të legjitimuara të BE-së, por në takime pak a shumë të fshehta të një pjese të vogël udhëheqësish.

Euroja, e krijuar me qëllim bashkimin e përhershëm të Europës, është bërë kërcënimi më i madh për të ardhmen e kontinentit. Një kolaps i bashkimit monetar do ta kthente Europën dekada mbrapa, do t'i jepte Europës një goditje pas së cilës nuk mund të ringrihet, sidomos po të kemi parasysh pozicionin e saj të kërcënuar tashmë nga rritja e shpejtë e Azisë. Si mund t'ia dalë me sukses një Europë e fragmentuar në këtë garë të re?

Kjo është arsyeja pse politikanët e Europës duan ta mbrojnë euron me çdo kusht. Ata po mundohen të fitojnë kohë, duke shpresuar se tregjet do të riekulibrohen dhe reformat do të jenë të qëdrueshme.

*Der Spiegel, 20 qershor 2011*

## FMN: Më shumë Europë ju lutem!

Revista britanike The Economist vë në dukje qëndrimin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, sipas të cilit zgjidhja e mundshme e krizës që ka mbërthyer eurozonën qëndron vetëm në thellimin e integritit evropian. Zakonisht, pak njerëz i kushtojnë vëmendje misionit të FMN-së lidhur me zonën e euros, i cili ka të bëjë me një lloj kontrolli shëndetësor vjetor. Por në një kohë kur zona e euros është në krizë të thellë, mendimi i një eksperti të jashtëm detyrimisht tërheq vëmendjen.

Dhe konkretisht, FMN-ja po i jep Bashkimit Evropian dy mesazhe:

Së pari, evropianët duhet të krijojnë një ide të qartë mbi krizën e debitit kombëtar, e cila po kërcënon të "shkatërrojë" përfitimet ekonomike të viteve të fundit në eurozonë dhe mund të shkaktojë "pasoja në nivel global". Me fjalë të tjera, "infeksioni" mund të përhapet nga periferia në qendër të Europës, dhe mund të infektojë shumë ekonomi të tjera. (Nga ana tjetër, zgjidhja e krizës do të ndihmonte ekonominë globale.)

Së dyti, dhe çka është më interesante, sipas FMN-

së, mënyra për të zgjidhur këtë problem nuk është ristrukturimi i borxhit kombëtar të shteteve të trazuara evropiane, por integrimi i mëtejshëm ekonomik. Me fjalë të tjera, "më shumë Europë".

Raporti i FMN-së mbi këtë çështje përmban një sërë rekomandimesh për BE-në për të ecur më me vendosmëri drejt "një qasjeje të vërtetë të bashkuar". Si fillim, udhëheqësit evropianë duhet t'i japin fund "debatit joproduktiv" mbi ristrukturimin e borxhit, i cili rrezikon infektimin e ekonomive të tjera.

Ekziston nevoja për një fond mbarë Evropian për të mbështetur bankat që janë në vështirësi. Fondi kryesor evropian i shpëtimit, i njohur si Instrumenti Evropian për Stabilitet Financiar (IESF), duhet rritur dhe forcuar si dhe të lejohet të blejë obligacionet e shteteve me probleme. Rregullat fiskale për qeveritë duhet të forcohen, të parashikohen sanksione më automatike për shkelësit dhe të parashikohet një rol më i madh për Komisionin Evropian në monitorimin dhe drejtimin e politikave ekonomike.

*The Economist, 21 qershor 2011*

## Qipro, bregdeti më i pastër në Bashkimin Evropian

...vijon nga faqja 1 >>

Duke krahasuar cilësinë e ujit në më shumë se 21.000 zona plazhi bregdetare dhe në brendësi të territorit në 27 vendet anëtare plus Kroaci, Mali i Zi dhe Zvicër, raporti konstaton se 18 vende kishin të paktën një plazh në mospërputhje me normat minimale. Shumica e këtyre plazheve u përkasin Polonisë (19 %), Holandës (11.8 %) dhe Belgjikës (8,9 %).

Në Malin e Zi, vend kandidat për anëtarësim në BE, të gjitha plazhet në bregdetin e Adriatikut përmbushnin vetëm vlerat e detyrueshme për cilësi të mirë ose të mjaftueshme. Asnjë nga plazhet nuk ka marrë vlerësim "të shkëlqyer" për statusin e cilësisë.

Plazhet buzë Detit të Zi në Rumani janë pothuajse të së njëjtës cilësi, me më pak se 5% të plazheve që kanë merituar vlerësimin maksimal për cilësinë e ujit.

Në përgjithësi, cilësia e plazheve në bregdet për sa i përket parametrave minimalë të detyrueshëm është përkeqësuar me 3,5 % në vitet 2009 - 2010. Gjithashtu, dhe cilësia e plazheve pranë ujërave të brendshme si lumenj apo liqene ka rënë ndjeshëm: vetëm një e katërta e plazheve pranë lumenjve arrijnë vlera të mira për sa i përket cilësisë së ujit.

*EU Observer, 16 qershor 2011*

## Pesë arsytet për të cilat projekti european po shkërmoqet

...vijon nga faqja 1 >>



Rael Hoxha,  
Dita e Europës, maj 2011

integritimit mund të kolapsojë, duke lënë të ardhmen e Europës pezull.”

### 1. Një projekt pa energji

Kjo krizë nuk është as e shkurtër dhe as e përkohshme: ne nuk po kalojmë thjesht një moment të vështirë, as nuk jemi viktimat të një pesimizmi të pabazë. Pas shumë arritjesh të shkëlqyera dhe premtimesh optimiste, projekti european po vihet në diskutim: në vend të Europës të suksesshme dhe të hapur që i kishim premtuar vetes, hasim një Europë që, pavarësisht nga zgjerimi, është ngushtuar; një Europë që, pavarësisht nga euroja, është bërë egoiste dhe pa solidaritet dhe që nuk beson më në vlerat e saj dhe nuk i praktikon më ato, por e ka rrethuar veten me frikë ndaj botës së jashtme dhe humbjes së identitetit. Pas 10 vitesh reformash institucionale, Traktati i Lisbonës, i cili kishte për qëllim të shpëtonte Europën nga paraliza dhe ta shoqëronte atë në shekullin e 21, mbetet shumë pak i njohur dhe arritjet e tij janë të padukshme.

### 2. Kriza e vlerave dhe mungesa e largpamësisë së politikës

Ashpërsia e krizës së tanishme europiane e ka origjinën e saj në konvergjencën e katër forcave centrifugale: rritja e ksenofobisë, kriza e euros, deficitit i politikës së jashtme dhe mungesa e lidershit. Çështjet janë paralele, por ato ndërthuren nëpërmjet një emëruesi të përbashkët të rrezikshëm: mungesa e një vizioni afatgjatë. Rezultati është që çdo divergjencë mes anëtarëve, pa marrë parasysh formën që merr, kthehet në një lojë me shumë zero, një betejë e egër, dhe qëllimi kryesor është një fitore

që të mund të tregohet në kryeqytetet kombëtare, pa marrë parasysh sa e vogël dhe sa e dëmshme mund të jetë për projektin e përbashkët european. Sot, në mes të krizës ekonomike, vlerat e tolerancës dhe të hapjes që ndërtuan trashëgiminë më të rëndësishme që kemi, janë në rrezik apo edhe në regres.

### 3. Fondi i solidaritetit

Thuhet se fajin e ka kriza ekonomike, por kjo nuk është plotësisht e vërtetë. Rreziku kryesor i projektit european nuk i kanoset nga kriza vetë: Europa është ballafaquar dhe më parë me kriza dhe ka dalë më e forcuar prej tyre. Sot, me gjithë vështirësitë serioze me të cilat përballen ekonomitë europiane (në veçanti në lidhje me plakjen e popullsisë dhe humbjen e konkurrencës), ekziston një konsensus i gjerë mbi si duhet të tejkalohen këto probleme. Problemi i vërtetë duhet të kërkohet diku tjetër: tek ekzistenca e pikëpamjeve të papajtuësme mbi si mbërritëm deri tek kriza e euros dhe, si pasojë, si duhet të dalim prej saj. Në vend që të ndjekim rrugën drejt thellimit të bashkimit, ajo që vërejmë është një qëndrim fitues - humbës ku disa vende përdorin gjendjen e tanishme për t'iu imponuar të tjerëve modelin e tyre ekonomik, sikur të gjitha vendet të ishin në të njëjtën gjendje dhe mund të funksiononin në bazë të rregullave të njëjta. Po të vazhdohet kështu, Bashkimi European do të përfundojë të shihet nga sytë e shumë europianëve, siç shihej Fondit Monetar Ndërkombëtar për shumë vende të Azisë dhe Amerikës Latine në vitet 1980 dhe 1990: një mjet për vendosjen e një ideologjie ekonomike të cilit i mungon legjitimiteti, por të cilit i binden për shkak të mungesës së ndonjë alternative. Gjërat ndoshta edhe mund të funksionojnë kështu, por Europa nuk do të jetë një projekt politik, ekonomik dhe shoqëror, por një trup i thjeshtë rregullator ngarkuar me mbikëqyrjen e stabilitetit makroekonomik i cili vuan nga një deficit i rëndë demokratik dhe identiteti.

### 4. Mungesa e Bashkimit European në arenën ndërkombëtare

Po aq serioze sa dështimi i bashkëpunimit të brendshëm është dhe paaftësia e Europës për të folur dhe vepruar me një zë të vetëm në arenën ndërkombëtare në shekullin e 21-të. Pavarësisht se përbën bllokun më të madh ekonomik dhe tregtar

në planet, ofruetin më të madh në botë të ndihmës për zhvillim dhe madje, pavarësisht shkurtimeve, vazhdon të ketë një aparat ushtarak dhe sigurie të konsiderueshëm, Europa ende ushtron një pushtet të fragmentuar dhe si rezultat, joefektiv. Këtë e vërejmë çdo ditë në marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara, Rusinë apo Kinën, ose me veprimet e saj në Mesdhe. Natyrisht, fuqia e Europës nuk është e krahasueshme me atë të një fuqie të madhe dhe as që synohet të ushtrohet në formën që e ushtrojnë të tjerat. Problemi është se Europa nuk është në gjendje të veprojë e bashkuar dhe e vendosur edhe në zonat më të afërta gjeografike, si Mesdheu, ku forca e saj duhet të jetë e madhe, ndërkohë që as nuk ushtron ndonjë ndikim domethënës në institucione të tilla si OKB, G20 apo FMN, ku pushteti i saj politik dhe ekonomik është i madh. Në të gjitha këto institucione shumëpalëshe, ka shumë vende europiane, por pak Europë, dhe, çka është më e keqja, ka pak politika që përshtaten me interesat e tyre.

### 5. Rebelimi i elitave

Për vite të tëra, projekti europian ka përparuar në bazë të konsensusit të nënkuptuar ndërmjet qytetarëve dhe elitave në lidhje me përfitimet nga procesi i integritimit. Ky konsensus tani është thyer në dy fronte. Në njërin anë, qytetarët kanë tërhequr besimin që ata i dhanë institucioneve europiane për t'i qeverisur "për njerëzit, por pa njerëz." Me kalimin e kohës, procesi i integritimit ka prekur fijet më të ndjeshme të identitetit kombëtar, sidomos në lidhje me mirëqenien dhe politikën sociale. Anshmëria në

politikat ekonomike, liberale dhe thjeshtëzimin e rregullave në sektorë të ndryshëm gjatë ndërtimit të Bashkimit European kanë sjellë politizimin dhe idealizimin e një projekti që më parë gjykohej si më i përshtatshëm të lihej në duart e ekspertëve. Por ajo që është më e çuditshme është se, së bashku me këtë rebelim të masave, ka edhe atë që ne mund ta quajmë "një rebelim të elitave". Liderët kombëtarë gjithnjë e më rrallë preferojnë të flasin mbi dhe aq më pak, pro Europës.

**Epilog.** Çdo ditë që kalon, ndjesia që Europa po përçahet është më reale dhe e justifikuar. A mund të rrënohet Europa e përbashkët? Përgjigja është e qartë: Po, sigurisht që mundet. Në fund të fundit, Bashkimi European është një ndërtim njerëzor, nuk është një trup qiellor. Pro-europianët janë të vetëdijshëm se rreziku i përçarjes së Europës është shumë real, dhe ata janë vazhdimisht të shqetësuar nga rrjedha e ngjarjeve. Megjithatë, në të njëjtën kohë, ata kanë frikë se të ushqyerit e pesimizmit me paralajmërime të kësaj natyre mund të shërbejë vetëm për të përshpejtuar rënien. Duke parë qartësinë e ideve dhe vendosmërinë me të cilën anti-europianët ndjekin objektivat e tyre, është e vështirë të besohet se vetëm optimizmi do të mjaftojë në vetvete për të shpëtuar Europën nga fantazmat e egoizmit dhe të ksenofobisë që e çenojnë për momentin. Pa një vendosmëri të përbashkët dhe qartësim të ideve, Europa do të dështojë.

*El Pais, 15 maj 2011*

## Dita e Europës



Rael Hoxha,  
Dita e Europës, maj 2011

Si çdo vit, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) ka festuar me të rinjtë Ditën e Europës. Në kuadër të 61 vjetorit të deklaratës së Robert Schuman, EMA organizoi një debat mes të rinjve mbi të drejtat e njeriut në BE si dhe një



Jetmir Lubonja, Dita e Europës, maj 2011

konkurs karikaturash për studentët e Akademisë së Arteve, Liceut Artistik dhe të tjerë të apasionuar. Qëllimi i kësaj iniciative ishte nxitja e artistëve të rinj që të reflektojnë mbi të ardhmen e BE-së dhe perspektivën europiane të Shqipërisë përmes artit vizual. Mes rreth 15 punimesh të përzgjedhura, karikaturat më të mira u vlerësuan ajo e Jetmir Lubonjës me diçiturën "Arritëm! Edhe pak!". Ndërsa vendi i dytë i shkoi Rael Hoxhës.

*Stafi i EuroSpeak, korrik 2011*



## Kartolina nga BE-ja

### Industria greke në lulëzim pavarësisht krizës së borxheve dhe trazirave

Ekonomia është në krizë të thellë. Qeveria mezi mbahet. Kryeqyteti vlon nga protestat gjatë ditës dhe natën shkretohet.

Por, për sa i përket turizmit Greqia nuk është fare e shqetësuar, pasi ndryshe nga viti i kaluar, 2011 pritet të jetë një vit i shkëlqyer. Dhe për vizitorët këtë verë, vendi premton të jetë një okazion i vërtetë. Turistët të cilët mund të kenë udhëtuar vitet e mëparshme drejt Afrikës së Veriut kanë zgjedhur kësaj here ishujt grekë. Me një rritje të turistëve prej të paktën 10%, kryesisht falë uljes së çmimeve, sektori përbën dritën e vetme në një peizazh të errësuar nga një betejë epike me borxhet e vendit.

Pavarësisht përballjes me greva dhe demonstrata, pushuesit duket se janë të lumtur të ndihmojnë

Greqinë - edhe nëse kjo do të thotë ndonjëherë ndeshjen e gazit lotsjellës të Athinës rrugës për në ishuj. Në mënyrë të veçantë, shënohet rritje e vizitorëve nga Turqia, Kina dhe India. Vizitorët rusë pritet të kalojnë 500.000 këtë vit, një rritje prej 50% në krahasim me vitin 2010.

Zyrtarët shpresojnë se rritja e numrit të vizitorëve do të shërbejë për të ndihmuar vendin të dalë nga kriza e thellë financiare. Turizmi në Greqi ofron një të pestën e vendeve të punës dhe pothuajse 18% të prodhimit të brendshëm bruto.

Muajin e kaluar, administrata ka reduktuar çmimin e biletave të traqeteve. Ky veprim u pasua nga heqja e disa tarifave në aeroportet jashtë Athinës, çka ka mundësuar reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit ajror. Një vendim i ngjashëm për të ulur TVSH-në nga 11% në 6.5% në akomodimin turistik e ka bërë vendin më konkurrues.

*The Guardian, 20 qershor 2011*

### Gjykata gjermane do të gjykojë nëse vendimet e BE-së mbi ndihmën për të zgjidhur krizën financiare janë kushtetuese

Ankthi gjerman rreth miliarda eurove që BE-ja po krediton për të mbajtur gjallë ekonominë e sëmura të eurozonës nuk është vetëm një çështje politike – disa argumentojnë se masat e shpëtimit janë të paligjshme.

Gjykata Kushtetuese Gjermane ka filluar shqyrtimin e një numri ankesash kundër këtyre vendimeve, ndërkohë që Greqia vazhdon të përfitojë ndihmë nga Bashkimi Europian.

A është Gjermania bankomati i Europës? Apo është vendi që i detyrohet më shumë asaj?

Një profesor gjerman i ekonomisë i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të argumentuar se ndihma financiare për të nxjerrë nga kriza Greqinë, Irlandën dhe Portugalinë bie ndesh me Kushtetutën gjermane. Nëse ai fiton – në një vendim që pritet të vijë pas rreth tre muajsh – ndihma prej miliarda eurosh do të bllokohet.

Sipas Prof. Markus Kerber ndihma në këtë formë është ilegale, sepse Kushtetuta gjermane parashikon



Foto: BBC News Europe

se: “Ne nuk jemi të lirë të hyjmë në një sistem inflacioni”.

Ai e sheh Kushtetutën të shkruar në rrënojat e luftës si garantues të stabilitetit financiar, i cili e ndalon qeverinë të shpenzojnë përtej mundësive. Kushtetuta i jep fuqinë e shpenzimeve parlamentit gjerman – dhe jo Bankës Qendrore Europiane, Komisionit Europian dhe Fondinit Monetar Ndërkombëtar.

Por si u forcua vetë Ekonomia gjermane pas luftës? Në kontrast me pikëpamjen e sipërpërmendur, Prof. Albrecht Ritschl, një historian gjerman i ekonomisë në London School of Economics pohon: “Kur është fjala për borxhin, Gjermania është mbret”.

...vijon në faqen 7 >>>



Prof Ritschl argumenton se Gjermania po përpiket të bëjë në Greqi pikërisht atë që kreditorët e saj nuk kanë bërë me të. Ata mendonin se sforcimi i tepërt i Gjermanisë lidhur me borxhin e saj do të ishte i dëmshëm. Kështu, vendosën se financimi i rindërtimit ishte një ide më e mirë.

Pozitiv mbetet fakti që në Gjermani një pjesë e shoqërisë diskuton për një "Plan Marshall për Greqinë" – ideja se një plan konstruktiv për riparimin e një ekonomie të dëmtuar mund të ketë efekt për

Greqinë, ashtu siç ndodhi me Gjermaninë.

Kjo pikëpamje është më popullore nga ç'mund të mendohet. Sipas një anketimi të kohëve të fundit, rreth gjysma e popullsisë është kundër ndihmave për Greqinë – dhe gjysma është pro. Mbi të gjitha, rreth 60% e gjermanëve e vlerësojnë pozitivisht eurozonën dhe e pranojnë që të qenit pjesë e saj mund të thotë që Gjermanisë i duhet të ndihmojë të tjerët.

*BBC News Europe, 5 korrik 2011*

## Një presidencë e re dhe e sigurt në vetvete për BE-në



Më 1 korrik 2011, Polonia mori presidencën e saj të parë në gjirin e BE-së. Ajo e ka filluar këtë detyrë me një siguri të spikatur, ndoshta dhe të ekzagjeruar dhe duke lëshuar disa akuza për hipokrizi dhe miopi ndaj liderëve europianë lidhur me përballjen me krizën.

Kryeministri polak, Donald Tusk i ka kritikuar liderët e Gjermanisë, Francës, Italisë dhe Britanisë për menaxhimin e krizës në Greqi, emigracionin, dhe shpenzimet e buxhetit të BE-së. Ai akuzoi ata se nga njëra anë hiqen si kampionë të Europës, ndërsa injorojnë dhe ndonjëherë edhe nxisin një formë të re të euro-skepticizmit për përfitime personale politike, si përdorimi i frikës në lidhje me emigracionin për të frenuar lirinë e udhëtimit në Europë.

Mbrojtja pasionale dhe optimiste e BE-së nga lideri polak ishte plotësisht në kundërshtim me humorin në Bruksel dhe kryeqytete të tjera të BE-së, ku angazhimi ndaj bashkimit është duke u gërryer nga shtimi i liderëve populistë, grindjet, dhe mosbesimi në rritje mes shteteve anëtare. Në kundërshtim me këtë atmosferë, Tusk tha: "Bashkimi European është vendi më i mirë në botë për të lindur dhe jetuar".

Në këto 6 muaj presidenciale të parë të BE-së, Polonia është përqendruar rreth tre prioriteteve kryesore:

- Integrimi europian si burim zhvillimi
- Një Europë e sigurt – ushqimi, energjia mbrojtja
- Europa që përfiton nga hapja ndaj vendeve të treta (fjala është në mënyrë të veçantë për fqinjët lindorë të BE-së, dikur pjesë e Bashkimit Sovietik).

*Stafi i EuroSpeak, korrik 2011*

## Italia dhe Spanja shprehen kundër përpjekjeve për krijimin e një patente Europiane

Ndonëse skema e patentës të BE-së është mbështetur nga 25 shtetet anëtare, ajo shihet si diskriminuese nga Roma dhe Madridi, të cilat depozituan më 30 Maj 2011, një ankesë në Gjykatën Europiane të Drejtësisë.

Ministria Italiane e Punëve të Jashtme përmes një deklaratë shprehet se: "Ankesa ka si qëllim mbrojtjen e vlerave të bashkësisë kundër abuzimit". Ndërkohë që i njëjti qëndrim vjen edhe nga Ministri Spanjoll i Çështjeve Europiane, Garridosaid Diego Lopez i cili thekson: "Spanja beson se një patentë e ardhshme europiane nuk mund të bazohet në diskriminim gjuhësor".

Nga ana tjetër mbështetësit e idesë së krijimit të një patente të vetme në BE thonë se është koha e zëvendësimit të sistemin aktual, i cili i detyron kompanitë që të marrin patentën e produkteve të tyre në secilën nga 27 vendet anëtare të bllokut dhe në 23 gjuhët zyrtare, duke e bërë këtë proces të kushtueshëm nga pikëpamja financiare.

...vijon në faqen 8 >>>



Aktualisht, titujt e patentave jepen nga Zyra Europiane e Patentave (EPO), e cila u themelua në 1977 dhe deri më tani mbulon 38 vende, duke përfshirë të gjitha vendet anëtare të BE-së. Më 15 shkurt, Parlamenti European dha miratimin e tij lidhur me përdorimin e procedurës së bashkëpunimit të zgjeruar nga shtetet anëtare me qëllim ngritjen e një sistemi të përbashkët patentash. Marrëveshja mes 25 vendeve i hapi rrugë krijimit të një patente europiane si dhe përdorimit të gjuhës angleze, frënge dhe gjermane si gjuhë zyrtare.

Megjithatë, e ashtuquajtura 'patentë Europiane' është në realitet asgjë më shumë se një paketë patentash kombëtare, nënshkruar sipas rregullave specifike të çdo shteti anëtar të BE. Situata rezulton të paraqesë vështirësi ligjore dhe kosto të lartë financiare për kompanitë që duan të mbrojnë produktet e tyre në hapësirën europiane. Presidenca Hungareze ka vlerësuar se pasojë e drejtpërdrejtë e një sistemi të fragmentuar të patentës shkon deri në rreth € 750.000.000 kosto shtesë mbi bizneset europiane çdo vit.

Një tjetër çështje potencialisht më e vështirë që nuk mbulohet nga marrëveshja ka të bëjë me krijimin e një sistemi të përbashkët juridik, pjesë e të cilës është edhe një gjykatë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ligjore.

*Euractiv, 31 maj 2011*

## Një Europë e grave?

A po shndërrohen gratë në Europë në promotor të ndryshimeve politike?

Aktualisht gratë perceptohen si agjentet më të mira dhe më të vendosura të ndryshimit. Ky perifraxim është po aq i vërtetë aktualisht për politikën Europiane, sa ka qenë edhe për ekonominë në disa pjesë të Afrikës dhe Azisë. Rezultatet e zgjedhjeve lokale në Itali mund të jenë sinjal i një dinamike fillestare elektorale. Ishin gratë që votuan për të nxjerrë jashtë skenës politike partinë e Silvio Berlusconi në Milano, një qytet që ai e ka kontrolluar për një periudhë të gjatë dhe njëkohësisht ka qenë vendi i origjinës së pushtetit të tij.

Ndonëse nuk ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë mes rezultateve të zgjedhjeve lokale në Itali dhe skandalit të Dominique Strauss-Kahn në New York, ky i fundit pati ndikimin e tij në mobilizimin e grave dhe votuesve të rinj italiane për rrëzimin e sundimit të Berlusconi.

Autori gjatë shkrimit të tij sjell në vëmendjen e lexuesve rastin e Islandës, ekonomia e të cilës përjetoi një falimentim drastik për shkak të sjelljes së papërgjegjshme të elitës politike dhe ekonomike të përbërë kryesisht nga meshkuj. Ndaj populli vendosi se vetëm një grua e fortë dhe e përgjegjshme në rolin e Presidentes mund të korrigjonte problemet e vendit.

Kriza aktuale ekonomike dhe sociale në vende të tilla si Greqia, Portugalia, dhe Spanja i ballafaqon gratë me një mundësi të re. Tashmë ato janë duke luajtur një rol gjithnjë e më në rritje lidhur me sigurinë financiare të familjeve të tyre. Dhe sa më e përhapur që kjo gjë të bëhet, aq më shumë gra do të kërkojnë një rol politik që reflekton forcën e tyre ekonomike.

Natyrisht, statusi i ndryshuar i grave nuk mund të përkthehet menjëherë në rritjen e ndikimit të tyre në politike. Por tashmë një dinamike e tillë duket të jetë në lëvizje. Madje, impulset pozitive që erdhën nga revolucioni në botën arabe duket se e rikonfirmojnë atë. Pikërisht, një numër kaq i madh njerëzish në mbarë botën që janë të etur për ndryshimin e status quo-së, e sjell politikën gjinore në qendër të vëmendjes në Europë dhe më gjerë. Çështja kryesore që shtrohet është nëse ky trend në rritje i grave në politikë do të mundësojë ofrimin e perspektivave dhe formave të reja të lidërshiptit.

*Project Syndicate, 23 qershor 2011*




Foto: www.HanksThinkTank.com

## Mungesa e grave në postet kryesore do të shkaktojë probleme për ekonominë e BE-së

Sipas Komisioneres Vivian Reding "Tregu i brendshëm i BE-së do të vuajë nëse kompanitë nuk marrin më shumë gra në bordet e tyre".

Komisionerja pohoi se në mars të vitit 2012, kompanitë do të vlerësohen nga Komisioni European nëse kanë pasur "progres të qartë, të saktë dhe të matshëm" drejt një barazie gjinore me domethënese në strukturat e tyre.

"Nëse po, nuk do të ketë nevojë për legjislacion europian. Nëse jo, do të kemi një problem me tregun e brendshëm," tha komisionerja duke shpjeguar se kompani të mëdha të cilat punojnë në të gjithë BE-në aktualisht ballafaqohen me ligje të ndryshme kombëtare për kuotat e përfshirjes së grave. Reding mendon se në qoftë se ka një tender të prokurimit publik në Spanjë, për shembull, kompanitë spanjolle që tashmë detyrohen nga ligjet e kuotave kombëtare do të kenë një avantazh të menjëhershëm ndaj një kompanie gjermane, e cila nuk i nënshtrohet këtij ligji.

Komisionerja synon të rrisë pozicionet e grave në bordet e kompanive në 30 % deri në vitin 2015 dhe në 40 % në vitin 2020.

Aktualisht, gratë përbëjnë 10 % të drejtorëve dhe 3 % e oficerëve ekzekutiv në kompanitë më të mëdha të BE-së, kurse numri i grave në bordet e korporatave rritet me rreth 0.5 % në vit.

*EU Observer, 13 korrik 2011*



Foto: www.kosova.info

## Europa humb një prej personaliteteve më të guximshme dhe largpamëse

Në 4 korrik, u nda nga jeta Otto von Habsburg, i biri i perandorit të fundit austro-hungarez. Por, më shumë se për origjinën aristokrate, ai duhet kujtuar për rolin e luajtur në momente kyçe të shekullit të XX. Me një vizion të spikatur pro Europës së bashkuar, hapjes së kufijve, emigracionit, dhe mbi të gjitha kundër luftërave, Otto von Habsburg la gjurmë si një opozitar i guximshëm i nazizmit, ku gjatë viteve të studimit në Berlin refuzoi të takonte Hitlerin, qëndrimet e të cilit i përçmonte publikisht. Gjatë Luftës së Ftohtë, ai ishte një kundërshtar i epur i komunizmit. Ai qe ndër organizatorët e piknikut Austro-Hungarez të verës 1989 - hapja për disa orë e kufirit mes dy vendeve - i cili shënoi plasaritjen e parë të Perdes së Hekurt që ndante Europën perëndimore me atë lindore, akt që konsiderohet themelor në rrëzimin e regjimeve komuniste në bllokun lindor.

Për rreth 20 vjet, Otto von Habsburg iu dedikua një karriere brilante si anëtar i Parlamentit European, duke lënë mënjanë inkurajimet për tu bërë president i Hungarisë, për të punuar fort për integrimin e Europës lindore në BE, dhe vitet e fundit, Ballkanit perëndimor.

*Stafi i EuroSpeak, korrik 2011*

## Në pritje të aderimit...



### Kroacia mbyll me sukses gjashtë vite negociatash me BE-në. Anëtarësimi, në 1 korrik 2013

Me 30 qershor 2011 - Shtetet Anëtare të BE-së vendosën të mbyllin bisedimet për pranimin e Kroacisë.

Ky vendim erdhi pas gjashtë vite negociatash gjatë të cilave Kroacisë i është kërkuar jo vetëm të miratojë ligje të reja dhe rregulla në përputhje me standardet e BE-së, por edhe t'i zbatojë ato, duke treguar se reformat janë të pakthyeshme.

Negociatat për pranimin e Kroacisë në BE, të cilat mbulonin 35 kapituj fushash të ndryshme, u hapën në tetor 2005, gjashtë muaj pasi vendi mori statusin kandidat.

Pas mbylljes së bisedimeve me shtetet anëtare të BE-së me 30 qershor, një traktat pranimi me Kroacinë pritet të nënshkruhet brenda gjashtë muajve, pas një opinioni zyrtar nga Komisioni, pëlqimit të Parlamentit Europian dhe një vendimi nga Këshilli i ministrave të BE-së.

Pas kësaj, secili nga Shtetet Anëtare dhe Kroacia do të fillojnë procedurat e ratifikimit në përputhje me rregullat e tyre kombëtare, në shumicën e rasteve nëpërmjet një votimi në parlament.

Pas procedurës së ratifikimit në të gjitha Shtetet Anëtare dhe Kroacisë, anëtarësimi mendohet të ndodhë në 1 korrik 2013.

*Stafi i EuroSpeak, korrik 2011*

### BE Maqedonisë: Reforma ose harroje anëtarësimin.

#### Vlerëson mbajtjen e zgjedhjeve cilësore

“Qeveria e re maqedonase duhet të vazhdojë të bëjë përpunim në reformat e nevojshme, përndryshe ajo rrezikon të humbasë rekomandimin e Komisionit për të filluar bisedimet për anëtarësim në BE”- tha Komisioneri i Zgjerimit, Stefan Fule pas takimit me kryeministrin Nikola Gruevski në Bruksel në fund të muajit qershor. Partia VMRO-DPMNE e qendrës së djathtë e Gruevskit fitoi zgjedhjet e fundit të përgjithshme të mbajtura më 5 qershor. Fule vlerësoi zhvillimin e zgjedhjeve dhe theksoi se Maqedonia “mund të jetë në mesin e atyre vendeve që udhëheqin rajonin drejt integritit më të thellë në BE”.

Gjithsesi procesi i integritit për momentin duket i bllokuar për shkak të mos zgjidhjes së çështjes së emrit të vendit. Vendosja e emërtimeve të reja dhe ngritja e përmendoreve të cilat evokojnë periudhën e Aleksandrit të Madh ka përkeqësuar marrëdhëniet me vendin fqinj, Greqinë.

Statuja e heroit të lashtë është ngritur në krye të një shtatëvani 10 metra të lartë, ndërsa struktura e plotë arrin 24 metra lartësi në horizontin e Shkupit. Me të vërtetë që kjo vepër të kujton shprehjen “sa më i vogël një komb, aq më të mëdha simbolet e tij”. Për vizitorët që e kanë parë nga afër statuja është aq e lartë sa nuk mund të kuadrohet as në fotografi. Maqedonia deri tani zyrtarisht e përshkruan skulpturën thjesht si një kalorës luftëtar, pa përmendur se luftëtari në fjalë është Aleksandri i Madh.

*Stafi i EuroSpeak, korrik 2011*

### “Pak Berlin” në Tiranë: Hapet Tirana Ekspres

Kur e viziton për herë të parë, të kujton qarqet e argëtimit dhe artit alternativ në Berlin. Në rreth 200 metra katrorë të organizuar me stil minimalist, pjesë e një kompleksi magazinash pranë hekurudhës, Tirana Ekspres është një qendër kulturore multifunkionale larg në koncept dhe distancë fizike nga shumica e vendeve klishe për argëtim që ofron kryeqyteti shqiptar. Ajo është një nismë e organizatës me të njëjtin emër që tenton t'i përgjigjet



kërkesës në rritje për art dhe kulturë në kryeqytet. Një hapësirë dhe peizazh alternativ për ekspozita, prezantime, shfaqje, kineforum apo dhe për të shijuar një birrë, që nga qershori, Tirana Ekspres po

gjallëron me originalitet netët e verës urbane.

*EuroSpeak, korrik 2011*



Foto: [www.tiranaexpress.blogspot.com](http://www.tiranaexpress.blogspot.com)



Foto: [www.tiranaexpress.blogspot.com](http://www.tiranaexpress.blogspot.com)



## A E DINI SE?



- Belgjika është vendi me dendësinë më të lartë të rrugëve dhe hekurudhave në botë.
- Belgjika është qendra më e madhe në botë e diamanteve.
- Sipas Forumit Ekonomik Botëror, Finlanda është ekonomia më konkurruese në botë.
- Franca është vendi më i vizituar në botë.
- Më shumë se gjysma e trashëgimisë kulturore botërore të mbrojtur nga UNESCO ndodhet në Itali.
- Luksemburgu ka Produktin e Brendshëm Bruto më të lartë për frymë në botë (58,900 dollarë).
- Në vitin 1967, Arvid Pardo, ambasadori i Maltës në OKB, propozoi që OKB-ja të deklarojë shtratin e deteve dhe oqeanëve përtej kufijve të juridiksionit kombëtar "trashëgimi të përbashkët të njerëzimit". Një Konventë që mbron këtë vizion hyri në fuqi më 14 nëntor 1994.
- Holanda, territori i së cilës përbën vetëm 0,008% të sipërfaqes së Tokës, është eksportuesi i tretë më i madh i produkteve bujqësore në botë.
- Porti i Roterdamit është porti më i madh në botë për sa i takon madhësisë dhe tonazhit.
- Portugalia investon më shumë se mesatarja e BE-së në arsim. Raporti mesatar një mësues për çdo nëntë nxënës është një nga më të lartët në botë.
- Suedia është eksportuesi i tretë më i madh muzikës në botë, pas SHBA-ve dhe Britanisë së Madhe.
- Londra ka tregun më të madh të këmbimit në botë.
- Porti i Konstancës, në pjesën rumune të bregut të Detit të Zi, është porti i dytë më i madh në Europë.
- BE-ja ka një sipërfaqe rreth 4 milion km<sup>2</sup> dhe ka 495.000.000 banorë - popullsia e tretë më e madhe në botë pas Kinës dhe Indisë.
- Kontributet e vetë BE-së së bashku me ato të



## A E DINI SE?

shteteve anëtare të saj, përbëjnë dhuruesit më të mëdhenj të ndihmës në botë.

Komisioni European punëson rreth 38 000 persona.

Por, sa kushtojnë strukturat e BE-së? Buxheti i BE-së nuk mund të kalojë 1,23% të të ardhurave bruto të BE-së. BE-ja shpenzon rreth 1% të buxhetit të saj vjetor për administrimin e stafit dhe mirëmbajtjen e

ndërtesave.

Edhe pse në BE jeton vetëm 7% e popullsisë së botës, tregtia e saj me pjesën tjetër të botës përfaqëson rreth 20% të eksporteve dhe importeve globale.

BE-ja është eksportuesi më i madh dhe importuesi i dytë në botë.

Stafi i EuroSpeak, korrik 2011

**EuroSpeak** është një revistë e përdymuajshme, e pasur me informacion të përditësuar dhe analiza mbi çështje të integritit european, me fokus të veçantë mbi zhvillimet e marrëdhënieve të BE-së me Shqipërinë dhe vendet e tjera të rajonit. Nga vetë emri, EuroSpeak (gjuha e përdorur nga burokratët në Bruksel dhe shpeshherë e kuptueshme vetëm për ekspertët), revista është projektuar për të përcjellë tek publiku i gjerë në një gjuhë më të lexueshme dhe jo teknike thelbin e debateve në gjirin e institucioneve të BE-së. Ajo synon të zvogëlojë hendekun aktual informativ mbi tema të tilla duke aspiruar të propozojë analizë cilësore dhe të pavarur e cila shkon përtej listimit të thatë të fakteve apo deklarave të politizuara mbi integrimin në BE që ndeshen shpesh në media.

Përmbledhjet apo ekstraktet e artikujve publikohen në zbatim të Ligjit Nr. 9380, datë 28.4.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me Të".

**Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)** është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritit european. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballet Shqipëria në rrugën drejt integritit european. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritit european. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave evropiane si dhe i procesit të integritit evropian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritit evropian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

Të gjithë numrat e EuroSpeak i gjeni dhe në sitin e Lëvizjes Europiane në Shqipëri: [www.em-al.org](http://www.em-al.org). Nëse dëshironi të merrni rregullisht buletin EuroSpeak nëpërmjet postës elektronike, na shkruani në [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org).

Për komente ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren, Blerta Hoxha, në adresën: [blerta.hoxha@em-al.org](mailto:blerta.hoxha@em-al.org)



Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert.